



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.84

11 qershor

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.478, datë 6.5.2009	Për klasifikimin e niveleve, sipas funksioneve të personelit inspektues dhe mbështetës të shërbimit të kontrollit të brendshëm, në Ministrinë e Brendshme	3683
Vendim i KM nr.480, datë 6.5.2009	Për mbrojtjen e veçantë personale, të familjes dhe të pronës së gjyqtarëve dhe për sigurimin e jetës e të pronës së tyre	3683
Vendim i KM nr.486, datë 6.5.2009	Për disa ndryshime dhe një shtesë në vendimin nr.18, datë 7.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve, që do të mbështeten, dhe të masave të përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”	3685
Vendim i KM nr.489, datë 6.5.2009	Për miratimin e kuadrit makroekonomik dhe të treguesve makroekonomikë e fiskalë, të rishikuar, për periudhën 2010-2012	3686
Udhëzim i MBUMK&MF nr.2, datë 31.3.2009	Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.269, datë 12.3.2009 “Mbi miratimin e mënyrës së përdorimit të fondeve kundërpartit, të mbledhura nga grantet japoneze për sektorin e bujqësisë dhe të ushqimit”	3690
Udhëzim i MB nr.348, datë 27.5.2009	Për procedurat dhe detyrat që duhet të zbatojnë prefektët dhe kryetarët e komunave për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për zgjedhësit pa pasaportë, të cilëve u duhet të udhëtojnë nga zonat e largëta për të aplikuar për letërnjoftim	3706
Urdhër i MB nr.374, datë 6.6.2009	Për orarin e punës për zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna	3707

VENDIM
Nr.478, datë 6.5.2009

**PËR KLASIFIKIMIN E NIVELEVE, SIPAS FUNKSIONEVE, TË PERSONELIT INSPEKTUES
DHE MBËSHTETËS TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM, NË MINISTRINË E
BRENDSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 74 të ligjit nr.10 002, datë 6.10.2008 “Për shërbimin e kontrollit të brendshëm, në Ministrinë e Brendshme”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Klasifikimi i niveleve, sipas funksioneve, të pesonelit inspektues dhe mbështetës të shërbimit të kontrollit të brendshëm, në Ministrinë e Brendshme, do të jetë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e vendimit.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

**TABELA E KLASIFIKIMIT TË NIVELEVE SIPAS FUNKSIONEVE PËR PERSONELIN INSPEKTUES
DHE MBËSHTETËS TË SHKB-së NË MINISTRINË E BRENDSHME**

KLASIFIKIMI I NIVELEVE	FUNKSIONI ORGANIK
Punonjës i nivelit të lartë drejtues	Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit
Punonjës i nivelit të mesëm drejtues	Drejtor në nivel qendror
Punonjës i nivelit të bazë drejtues	Shef sektori në nivel qendror
Punonjës i nivelit të bazë zbatues	Inspektor dhe specialist në nivel qendror

VENDIM
Nr.480, datë 6.5.2009

**PËR MBROJTJEN E VEÇANTË PERSONALE, TË FAMILJES DHE TË PRONËS SË
GJYQTARËVE DHE PËR SIGURIMIN E JETËS E TË PRONËS SË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9 e 10 të ligjit nr.9110, datë 24.7.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”, të nenit 24 të ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “dh”, të nenit 4 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Gjyqtarëve të gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda dhe të gjykatës së apelit për krime të rënda u sigurohet mbrojtje e veçantë personale, të familjes dhe të pronës, sipas parashikimeve të këtij vendimi, kur, për shkak të detyrës, u rrezikohet jeta, familja dhe prona.

2. Me mbrojtje të veçantë personale, sipas këtij vendimi, do të kuptohen masat me karakter organizativ dhe profesional, për sigurimin dhe ruajtjen e veçantë fizike, mbrojtjen e familjes dhe të pronës së gjyqtarëve, si dhe masat e tjera, që lidhen me këtë mbrojtje.

3. Për shqyrtimin e kërkesës për sigurimin e mbrojtjes së veçantë ngrihet komisioni i posaçëm për mbrojtjen e gjyqtarëve (më poshtë “Komisioni”), i cili përbëhet nga:

- a) Një përfaqësues i Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- b) Një përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë;
- c) Një përfaqësues i Ministrisë së Brendshme;
- ç) Kryetari i Gjykatës, pranë së cilës ushtron detyrën gjyqtari, për të cilin kërkohet mbrojtje;
- d) Një përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Kryetar i komisionit është përfaqësuesi i KLD-së. Në mungesë të kryetarit, anëtarët thirren nga personi i autorizuar prej tij, i cili kryeson mbledhjen e komisionit. Masa e shpërblimit të anëtarëve të komisionit është 5000 (pesë mijë) lekë për çdo mbledhje.

4. Kërkesa për mbrojtje të veçantë i paraqitet komisionit me shkrim nga:

- a) gjyqtari;
- b) përfaqësuesi i Policisë së Shtetit në komision ose një përfaqësues i autorizuar prej tij.

5. Kriteret, për të përfutur për mbrojtje të veçantë, janë:

- a) Kërkesa me shkrim;
- b) Prania e rrethanave serioze, që rrezikojnë jetën, familjen ose pronën e gjyqtarit;
- c) Prania e lidhjes shkakore, ndërmjet rrethanave serioze dhe ushtrimit të detyrës nga gjyqtari.

6. Kërkesa me shkrim e gjyqtarit, që kërkon mbrojtje të veçantë, duhet të përmbajë:

- a) Gjeneralitetet e plota të gjyqtarit kërkues;
- b) Një përmbledhje e fakteve dhe të rrethanave, që përbëjnë rrezik serioz për gjyqtarin, të cilat e detyrojnë atë të kërkojë mbrojtje të veçantë, si dhe burimin e provave, ku bazohen ato;
- c) Llojin e masës dhe kohëzgjatjen e saj.

7. Kërkesa për mbrojtje i paraqitet KLD-së nga përfaqësuesi i Policisë së Shtetit ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij, atëherë kur ka të dhëna të besueshme, që provojnë se një gjyqtari i rrezikohet jeta, familja ose prona. Përfaqësuesi i Policisë së Shtetit njofton menjëherë kryetarin, i cili merr masa të shpejta për mbledhjen e komisionit.

Kur rreziku ndaj gjyqtarit është serioz dhe i çastit, përfaqësuesi i Policisë së Shtetit në komision urdhëron strukturat e Policisë së Shtetit të marrin masa të menjëhershme, për të garantuar jetën, familjen ose pronën e gjyqtarit, deri në mbledhjen e komisionit. Komisioni, pas shqyrtimit të kërkesës, vlerëson masat e marra nga strukturat e Policisë së Shtetit dhe vendos, kur është rasti, për vazhdimin e mëtejshëm të tyre.

8. Kryetari, menjëherë pas marrjes së kërkesës për mbrojtje, njofton anëtarët e komisionit për mbledhjen e radhës. Komisioni duhet të mbledhet menjëherë dhe jo më vonë se 48 orë nga paraqitja e kërkesës, sipas pikës 5 të këtij vendimi. Mbledhjet e komisionit zhvillohen në ndërtesën e KLD-së. Komisioni mund të asistohet nga një sekretar, i caktuar nga përfaqësuesi i KLD-së, i cili mban procesverbalin e zhvillimit të mbledhjes.

9. Mbledhjet e komisionit janë të vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se katër anëtarë të tij. Vendimet janë të vlefshme kur miratohen të paktën nga tre anëtarë, të pranishëm në mbledhje. Kur numri i votave të anëtarëve pro dhe kundër është i barabartë, gjyqtari e përfiton mbrojtjen e veçantë.

10. Komisioni merr në shqyrtim kërkesën e paraqitur dhe, kur bindet për nevojën e sigurimit të mbrojtjes për gjyqtarin, shprehet me vendim për të. Vendimi përmban masat konkrete të mbrojtjes së veçantë, numrin e shoqëruesve personalë, kur është rasti, afatin, brenda të cilit sigurohet mbrojtja, si dhe masa të tjera, që lidhen me këtë mbrojtje. Vendimi i komisionit i njoftohet gjyqtarit nëpërmjet kryetarit të gjykatës, ku ushtron detyrën, dhe strukturave përgjegjëse për mbrojtjen, nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

11. Komisioni, me kërkesë të gjyqtarit në mbrojtje, mund të vendosë zgjatjen e afatit të masave të mbrojtjes, nëse rrethanat, për të cilët është siguruar më parë mbrojtja, vazhdojnë të ekzistojnë edhe pas përfundimit të këtij afati.

12. Sigurimi i mbrojtjes së veçantë zbatohet me kërkesë të gjyqtarit, i cili kërkon mbrojtje dhe, në rastin e gjyqtarëve të tjerë të sistemit të drejtësisë, sipas kriterëve e kushteve të përcaktuara në këtë vendim.

13. Shteti siguron jetën, aftësinë për punë dhe pronën e gjyqtarëve të gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda dhe të gjykatës së apelit për krime të rënda, nëpërmjet lidhjes së kontratave të sigurimit me shoqëritë e sigurimit, gjatë të gjithë kohës, që ata ushtrojnë detyrën. Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, pasi përcakton numrin e gjyqtarëve, të cilëve u sigurohet jeta, shëndeti dhe prona, lidh kontratën e sigurimit për çdo gjyqtar. Prona sigurohet nga zjarri dhe veprimet keqdashëse dhe përfshin vetëm banesën, në pronësi të gjyqtarit ose të familjarit të tij bashkëjetues.

14. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen si më poshtë vijon:

a) shpenzimet operative për organizimin e mbledhjeve të komisionit të posaçëm, nga buxheti i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

a) Shpenzimet për lidhjen e kontratave të sigurimit nga buxheti i Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor.

15. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Brendshëm, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.486, datë 6.5.2009

PËR DISA NDRYSHIME DHE NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.18, DATË 7.1.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE, QË DO TË MBËSHTETEN, DHE TË MASAVE TË PËRFITIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr.9917, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.18, datë 7.1.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shkronjat “a” e “b” të pikës 4, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a” mbjelljen e pemëve frutore (mollë, dardhë, kumbull, qersh, pjeshkë, lajthi, luleshtrydhe), ullinjve dhe agrumeve në bllok, jo më pak se 4 dynym, por jo më shumë se 1 ha, për fermerë individualë, dhe jo më pak se 1 ha, por jo më shumë se 5 ha, për grup fermerësh, 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, për format tradicionale, dhe 300 000 (treqind mijë) lekë/ha, për format intensive të kultivimit të tyre.

b) mbjelljen e vreshtave në bllok, jo më pak se 5 dynym, por jo më shumë se 2 ha, për fermerët individualë, dhe jo më pak se 1 ha, por jo më shumë se 5 ha, për grup fermerësh, 400 000 (katërqind mijë) lekë/ha.”.

b) Pas shkronjës “l” shtohet shkronja “m”, me këtë përmbajtje:

“m” mbjelljen e varieteteve autoktone të perimeve (domate, trangull, spec, qepë, patate) në bllok, jo më pak se 2 dynym, por jo më shumë se 1 ha, për fermerët individualë, dhe jo më pak se 1 ha, por jo më shumë se 5 ha, për grup fermerësh, 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha.”.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.489, datë 6.5.2009

PËR MIRATIMIN E KUADRIT MAKROEKONOMIK DHE TË TREGUESVE
MAKROEKONOMIKË E FISKALË, TË RISHIKUAR, PËR PERIUDHËN 2010-2012

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal, 2010-2012, të rishikuar dhe të treguesve makroekonomikë e fiskalë, të rishikuar, për periudhën 2008-2012, përkatësisht, sipas lidhjeve nr.1 “Treguesit kryesorë makroekonomikë”, dhe nr.2 e nr.2/1 “Treguesit fiskalë, sipas buxhetit të konsoliduar”, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

Treguesit kryesorë makroekonomik

Treguesit	Njësia	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
				Vler.	Vler.	Para.	Para.	Para.	Para.
(Cmimet)									
Inflacioni (mesatar)	%	2.4	2.4	2.9	3.4	2.5	3.0	3.0	3.0
Inflacioni (fund-viti)	%	2.0	2.6	3.1	2.2	2.8	3.0	3.1	3.1
Deflatori i PBB	%	2.6	3.6	3.8	3.5	2.7	3.3	3.2	3.2
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	99.9	98.1	90.4	83.9	96.5	97.0	96.8	96.8
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	124.3	123.0	123.9	122.8	129.0	127.0	125.7	126.1
(Treguesit e Sektorit Real)									
Rritja reale e PBB	%	5.8	5.5	6.3	7.2	4.8	6.1	7.0	6.8
Rritja sipas PBB tremujore/1					8.0				
PBB	Lek miliardë	814.8	891.0	982.7	1090.3	1173.8	1286.0	1420.3	1565.2
Norma e papunësisë	%	14.1	13.8	13.2	12.7	12.9	12.1	10.8	9.7
(Bilanci Kursime - Investime)									
Kursimet e brendshme	% të PBB	28.0	28.6	26.5	24.6	27.0	28.4	29.2	30.4
Publike	% të PBB	1.4	2.8	3.2	4.2	4.6	5.3	5.6	5.7
Private	% të PBB	26.6	25.8	23.3	20.4	22.4	23.1	23.6	24.7
Kursimet e huaja	% të PBB	9.0	6.5	10.5	14.5	9.3	7.3	6.6	5.6
Investimet	% të PBB	37.0	35.1	37.0	39.1	36.3	35.7	35.8	36.0
Publike	% të PBB	5.6	6.7	6.5	9.3	8.8	8.4	8.1	8.0
nga të cilat: Qeveria qendrore		4.7	5.7	5.8	8.5	7.7	7.3	7.0	6.9
Private	% të PBB	31.4	28.4	30.5	29.8	27.5	27.3	27.7	28.0
(Treguesit Fiskal)									
Të ardhurat totale	Lek miliard	204.2	229.4	251.6	290.1	334.8	368.3	409.3	453.3
Shpenzimet totale	Lek miliard	232.3	258.8	285.0	350.3	384.8	411.7	453.0	498.5
Bilanci i përgjithshëm	Lek miliard	-28.2	-29.4	-33.5	-60.2	-50.0	-43.4	-43.7	-45.2
Huamarrja e Brendshme Neto	Lek miliard	20.6	20.7	17.0	15.0	41.5	29.7	30.6	31.5
Të Ardhura nga Privatizimet	Lek miliard	0.9	2.0	13.2	5.5	0.2	0.3	0.3	0.3
Huamarrja e Huaj Neto	Lek miliard	5.9	5.3	5.0	34.7	8.3	8.8	8.8	9.7
Të ardhurat totale	% të PBB	25.1	25.8	25.6	26.6	28.5	28.6	28.8	29.0
Shpenzimet totale	% të PBB	28.5	29.0	29.0	32.1	32.8	32.0	31.9	31.9
nga të cilat: Interesa	% të PBB	3.2	2.8	2.6	2.9	3.1	2.9	2.8	2.7
Bilanci i përgjithshëm	% të PBB	-3.5	-3.3	-3.4	-5.5	-4.3	-3.4	-3.1	-2.9
Bilanci Primar	% të PBB	-0.3	-0.5	-0.8	-2.6	-1.2	-0.5	-0.2	-0.2
Huamarrja e brendshme neto	% të PBB	2.5	2.3	1.7	1.4	3.5	2.3	2.2	2.0
Të ardhura nga privatizimet	% të PBB	0.1	0.2	1.3	0.5	0.0	0.0	0.0	0.0
Huamarrja e huaj neto	% të PBB	0.7	0.6	0.5	3.2	0.7	0.7	0.6	0.6
Borxhi publik total	% të PBB	57.4	55.5	52.6	54.6	55.0	53.2	50.9	48.8
I Brendshëm	% të PBB	40.2	39.2	37.6	36.7	37.7	36.7	35.4	34.1
I Huaj	% të PBB	17.3	16.3	15.0	17.9	17.3	16.5	15.6	14.7
(Treguesit Monetare) /2									
Paraja e gjerë (M3)	% të PBB	70.9	75.7	77.5	74.8				
Rritja	%	14.0	16.7	12.9	7.1				
Shpejtësia (V)	Numër	1.4	1.3	1.3	1.3				
Kredia drejt sektorit privat	% të PBB	14.9	21.4	28.9	34.4				
Rritja	%	74.9	57.6	48.5	32.4				
(Treguesit e Sektorit të Huaj)									
Bilanci tregtar (Mallra & Shërbime)	% të PBB	-24.7	-23.3	-26.4	-27.4	-21.0	-18.8	-17.8	-16.6
Mallra	% të PBB	-22.5	-22.9	-26.5	-27.2	-23.6	-22.4	-21.8	-21.2
Bilanci i llogarisë korrente	% të PBB	-9.0	-6.5	-10.5	-14.5	-9.3	-7.3	-6.6	-5.6
Bilanci i pagesave	% të PBB	1.9	2.9	1.9	2.2	-0.7	0.4	0.8	1.4
Bilanci i pagesave	USD milion	155.4	259.0	203.6	280.8	-88.5	54.8	122.7	220.0
Rezervat valutore	USD milion	1325.5	1700.0	2033.9	2367.2	1969.4	2014.1	2141.0	2360.9
Në muaj importi mall e shërb	Muaj	4.2	4.5	3.8	4.0	4.2	4.0	3.8	3.8
Në % të parasë së gjerë	%	23.7	23.6	22.2	24.4	21.7	19.7	18.4	18.4

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave

1/Rritja për vitin 2008 sipas Produktit të Brendshëm Bruto Tremujor - INSTAT

2/ Parashikimet e MF të treguesve monetarë për vitet 2009 - 2012 nuk janë paraqitur për të evituar keq perceptimet e mundëshme, pasi disa prej këtyre tregues janë objektiva sasiorë për autoritetin monetar

TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR

ne milion leke (million lek)

Nr.	E M E R T I M I	2005				2006				2007				2008				2009				2010				2011				2012			
		TOTALI TE ARDHURAVE				TOTALI SHPENZIMEVE				TOTALI SHPENZIMEVE				TOTALI SHPENZIMEVE				TOTALI SHPENZIMEVE				TOTALI SHPENZIMEVE				TOTALI SHPENZIMEVE							
I.	Ndihmat	204,163	229,444	251,555	290,078	334,823	368,309	409,346	453,335																								
II.	Te ardhura tatimore	183,816	205,523	228,164	264,080	305,988	337,946	376,896	418,437																								
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	135,605	155,102	176,808	205,179	230,168	254,714	282,978	313,546																								
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	64,534	74,268	87,771	107,093	117,491	130,415	145,032	160,835																								
2	Tatimi mbi Fitimin	19,237	22,258	21,077	18,108	20,813	23,331	25,946	28,773																								
3	Akizat	18,523	22,997	28,731	32,510	44,363	49,730	55,852	62,551																								
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	7,402	8,580	14,850	24,385	26,085	28,646	31,541	34,631																								
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	12,281	13,008	14,531	14,423	15,312	16,991	18,527	20,145																								
6	Taksa Doganore	13,629	13,991	9,848	8,660	6,124	5,600	6,080	6,611																								
II.2	Te ardhura nga Pushteti Lokal	12,019	11,112	9,366	11,307	18,412	20,947	23,434	26,153																								
II.3	Te ardh Buxh. Pavarur (kontribute)	36,192	39,309	41,989	47,594	57,408	62,285	70,484	78,737																								
III.	Te ardhura jotatimore	14,178	15,895	22,112	22,950	22,522	23,873	25,306	26,824																								
I.	Shpenzime Korrente	232,339	258,816	285,016	350,267	384,834	411,735	453,020	498,539																								
I.1	Personeli	193,964	204,860	224,976	250,493	286,798	307,572	338,038	372,631																								
I.2	Interesat	53,674	56,709	59,087	66,618	62,751	67,771	75,226	83,125																								
I.3	Te brendshme	26,029	25,006	25,594	31,307	36,040	37,240	40,316	42,003																								
1	Te brendshme	24,184	22,978	23,499	28,386	31,420	32,000	34,000	35,000																								
2	Te Huaja	1,845	2,028	2,096	2,921	4,620	5,240	6,316	7,003																								
I.4	Shpenzime Operative Mirembajtje	24,515	22,794	25,259	28,956	35,813	40,469	47,348	55,398																								
I.5	Subvencionet	3,653	3,835	3,536	2,655	2,022	2,500	2,900	2,900																								
I.6	Mbeshetje per Energji	0	0	5,000	0	0	0	0	0																								
I.7	Shpenzime per Sig. Sociale dhe transferime te tjera	55,876	60,029	69,892	76,207	95,866	100,417	107,195	115,770																								
I.8	Buxheti lokal	19,999	22,713	21,340	27,122	36,835	39,432	42,634	47,732																								
II.	Shpenzime te tjera	10,218	13,775	15,268	17,729	16,871	19,042	21,220	24,003																								
III.	Fondi Rezerve	0	0	0	0	12,600	9,952	14,873	17,872																								
IV	Shpenzime Kapitale	38,375	51,108	57,040	92,367	90,436	94,211	100,109	108,035																								
	Transferata te ndryshme	0	2,848	3,000	7,406	-5,000	0	0	0																								
DEFICITI		-28,176	-29,372	-33,461	-60,188	-50,011	-43,426	-43,674	-45,204																								
FINANCIIMI DEFICITIT		28,176	29,372	34,119	60,188	50,011	43,426	43,674	45,204																								
Brendshem		23,298	23,623	28,829	24,527	41,699	34,626	34,924	35,544																								
Te ardhura nga Privatizimi		887	1,972	13,246	5,537	200	300	300	300																								
Hua-marje e brendeshme		20,617	20,742	17,039	18,012	41,499	29,718	30,600	31,514																								
Te tjera		1,795	909	-1,456	978	0	4,608	4,024	3,730																								
I Huaj		4,878	5,749	5,289	35,662	8,312	8,800	8,750	9,660																								
Hua afatgjate(e marre)		9,221	9,936	9,109	38,947	15,462	17,000	18,000	19,000																								
Ndryshimi i gjendjes se arkës		-379	403	279	963	0	0	0	0																								
Rrëqaset		-3,364	-4,530	-4,098	-4,248	-7,150	-8,200	-9,250	-9,340																								

TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR
ne % te PBB

Nr.	E M E R T I M I	2005		2006		2007		2008		2009		2010		2011		2012	
		TOTALI TE ARDHURAVE		TOTALI SHPENZIMEVE		TOTALI SHPENZIMEVE		TOTALI SHPENZIMEVE		TOTALI SHPENZIMEVE		TOTALI SHPENZIMEVE		TOTALI SHPENZIMEVE		TOTALI SHPENZIMEVE	
I.	Ndihmat	25.1	0.8	25.8	0.9	25.6	0.1	26.6	0.3	28.5	0.5	28.6	0.5	28.8	0.5	29.0	0.5
II.	Te ardhura tatimore	22.6	23.1	23.1	23.2	23.2	24.2	24.2	26.1	26.1	26.3	26.3	26.5	26.5	26.7	26.7	26.7
II.1	Nga Tatimet dhe doganat	16.6	17.4	17.4	18.0	18.0	18.8	18.8	19.6	19.6	19.8	19.8	19.9	19.9	20.0	20.0	20.0
1	Tatimi mbi vleren e Shtuar	7.9	8.3	8.3	8.9	8.9	9.8	9.8	10.0	10.0	10.1	10.1	10.2	10.2	10.3	10.3	10.3
2	Tatimi mbi Filtimin	2.4	2.5	2.5	2.1	2.1	1.7	1.7	1.8	1.8	1.8	1.8	1.8	1.8	1.8	1.8	1.8
3	Akcizat	2.3	2.6	2.6	2.9	2.9	3.0	3.0	3.8	3.8	3.9	3.9	3.9	3.9	4.0	4.0	4.0
4	Tatimi mbi le Ardhurat Personale	0.9	1.0	1.0	1.5	1.5	2.2	2.2	2.2	2.2	2.2	2.2	2.2	2.2	2.2	2.2	2.2
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.3	1.3	1.3	1.3	1.3	1.3	1.3	1.3	1.3	1.3	1.3
6	Taksa Doganore	1.7	1.6	1.6	1.0	1.0	0.8	0.8	0.5	0.5	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4
II.2	Te ardhura nga Pushteti Lokal	1.5	1.2	1.2	1.0	1.0	1.0	1.0	1.6	1.6	1.6	1.6	1.6	1.6	1.6	1.6	1.6
II.3	Te ardh Buxh. Pavarur (kontribute)	4.4	4.4	4.4	4.3	4.3	4.4	4.4	4.9	4.9	4.8	4.8	5.0	5.0	5.0	5.0	5.0
III.	Te ardhura Jotatimore	1.7	1.8	1.8	2.2	2.2	2.1	2.1	1.9	1.9	1.9	1.9	1.8	1.8	1.7	1.7	1.7
TOTALI SHPENZIMEVE																	
I.	Shpenzime Korrente	28.5	29.0	29.0	29.0	29.0	32.1	32.1	32.8	32.8	32.0	31.9	31.9	31.9	31.9	31.9	31.9
I.1	Personeli	6.6	6.4	6.4	6.0	6.0	6.1	6.1	5.3	5.3	5.3	5.3	5.3	5.3	5.3	5.3	5.3
I.2	Interesat	3.2	2.8	2.8	2.6	2.6	2.9	2.9	3.1	3.1	2.9	2.8	2.7	2.8	2.7	2.7	2.7
1	Te brendshme	3.0	2.6	2.6	2.4	2.4	2.6	2.6	2.7	2.7	2.5	2.4	2.4	2.4	2.2	2.2	2.2
2	Te Huaja	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.3	0.3	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4
I.3	Shpenzime Operative Mirembajtje	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
I.4	Subvencionet	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
I.5	Mbeshjetje per Energji	6.9	6.7	6.7	7.1	7.1	7.0	7.0	8.2	8.2	7.8	7.5	7.4	7.5	7.4	7.4	7.4
I.6	Shpenzime per Sig. Sociale dhe transferime te tjera	2.5	2.5	2.5	2.2	2.2	2.5	2.5	3.1	3.1	3.1	3.1	3.0	3.0	3.0	3.0	3.0
I.7	Buxheti lokal	1.3	1.5	1.5	1.6	1.6	1.6	1.6	1.4	1.4	1.4	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5
I.8	Shpenzime te tjera	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
II.	Fondi Rezerve	4.7	5.7	5.7	5.8	5.8	8.5	8.5	7.7	7.7	7.3	7.0	6.9	7.0	6.9	6.9	6.9
III.	Shpenzime Kapitale	0.0	0.3	0.3	0.3	0.3	0.7	0.7	-0.4	-0.4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
IV	Transferime te ndryshme	-3.5	-3.3	-3.3	-3.4	-3.4	-5.5	-5.5	-4.3	-4.3	-3.4	-3.1	-2.9	-3.1	-2.9	-2.9	-2.9
FINANCIMI DEFICITIT																	
Brendshem																	
Te ardhura nga Privatizimi																	
Hua-marje e brendeshme																	
Te tjera																	
I Huaj																	
Hua aliajgate(e marre)																	
Ndryshimi i gjendjes se arkës																	
Rrugesat																	

UDHËZIM
Nr.2, datë 31.3.2009

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.269, DATË 12.3.2009 “MBI MIRATIMIN E MËNYRËS SË PËRDORIMIT TË FONDEVE KUNDËRPARTI, TË MBLEDHURA NGA GRANTET JAPONEZE PËR SEKTORIN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.269, datë 12.3.2009 “Mbi miratimin e mënyrës së përdorimit të fondeve kundërparti, të mbledhura nga grantet japoneze për sektorin e bujqësisë dhe të ushqimit”

UDHËZOJMË:

I. TË PËRGJITHSHME

Fondet kundërparti të granteve japoneze të mbledhura nga projekti “Rritja e prodhimit ushqimor “2KR”, në shumën 320,000,000 lekë (treqind e njëzet milionë lekë), të derdhen në Buxhetin e Shtetit.

2. Këto fonde të përdoren gjatë vitit 2009, me kredi pa interes, për rritjen e prodhimit agro-industrial, në këto drejtime:

- ndërtim dhomash frigoriferike;
- blerje dhe instalim të linjave për përpunimin e qumështit; dhe
- blerje dhe instalim linjash për përpunimin e fruta-perimeve.

3. Masa e financimit të jetë në varësi të vlerës së linjës apo makinerisë, por jo më shumë se:

- a) 5 (pesë) milionë lekë, për dhomat frigoriferike;
- b) 10 (dhjetë) milionë lekë, për blerje dhe instalim linjash të përpunimit të qumështit;
- c) 15 (pesëmbëdhjetë) milionë lekë, për blerje dhe instalim linjash të përpunimit të fruta-perimeve.

4. Vlera për ndërtim dhomash frigoriferike, për blerje dhe instalim të linjave të përpunimit të qumështit dhe të fruta-perimeve, që do të financohen nga ky fond, të shlyhen, nga subjektet përfituese, me këste, si fonde kundërparti, pa interes dhe për një afat 7-vjeçar, duke filluar nga data e livrimit të plotë të fondit.

II. DREJTIMET DHE KRITERET E FINANCIMEVE

A. NDËRTIM DHOMASH FRIGORIFERIKE

1. Kriteria të përfitimit

- Përfitojnë subjektet fizike dhe juridike që kryejnë aktivitetin në bujqësi dhe blegtori, si dhe shoqëritë e prodhimit dhe tregtimit në bujqësi, që janë të regjistruara dhe funksionojnë në bazë të ligjit nr.8088, datë 21.3.1996 “Për shoqëritë e bashkëpunimit reciprok”, i ndryshuar. Zonat gjeografike prioritare janë: Korçë, Devoll, Pogradec, Dibër, Berat dhe Elbasan.

- Subjektet fizike/juridike, fermerët, shoqëritë që janë debitorë ndaj ish-projektit “2KR/AZHBR” përjashtohen nga aplikimi.

2. Aktiviteti që mbështetet nëpërmjet kësaj mase:

- Për ndërtim dhomash ruajtje frigoriferike për produktet bujqësore dhe blegtorale.

3. Kriteret që duhet të plotësojë aplikanti:

Subjekti ose shoqëria aplikuese duhet të paraqesë pranë Drejtorisë së AZHBR-së, Tiranë, një dosje që duhet të përmbajë këtë dokumentacion:

a) Të paraqesë biznesplanin e detajuar (3-vjeçar), i cili duhet të përfshijë:

- Prezantimin e shoqërisë ose subjektit fizik apo juridik, aktivitetin (nëse ka), regjistrimin si biznes pranë tatimeve, historikun bankar dhe financiar (nëse ka);
- Pasqyrat financiare (planinvestimin, analizat e qarkullimit të parasë (*cash flow*), analizë kosto produkti, burimet e financimit);
- Studim tregu mbi fushën e investimit (për llojin e produktit, kapaciteti ruajtës etj.);
- Planin e marketingut;
- Analizë risku.

- b) Plan disenjimi për investimin (Planimetria dhe skicimi i investimit).
- c) Pronësia e tokës bazuar në planin e disenjimit (që mund të përdoret për kolateral dhe pa barrë hipotekore) që vërteton origjinën e pasurisë dhe një certifikatë aktuale të hipotekës, (jo më herët se 3 muaj nga data e aplikimit). Në rastet kur toka ku do të bëhet investimi është me qira duhet të paraqitet kontratë qiraje ligjore, e cila duhet të ketë minimalisht kohëzgjatje për 10 vjet.
- d) Përfituesi duhet të ketë një kolateral të mjaftueshëm dhe jo më pak se 100% të vlerës së përfiturar. Në kolateral përfshihen pasuri të paluajtshme (truall, tokë bujqësore, objekte etj.);
- e) Marrëveshje paraprake për blerjen e pajisjeve, si dhe përshkrimet teknike të tyre. Teknologjia që do përdoret, makineritë duhet të jenë të reja dhe të certifikuara nga KE.
- f) Kontrata apo marrëveshje me furnizuesit apo blerësit për produktet.
- g) Dokumente që vërtetojnë që përfituesi nuk ka mbi vete asnjë barrë detyrimi bankar nga Banka e Shqipërisë, regjistri i kredisë.
- h) Dokument nga zyra e tatimeve që nuk ka detyrime tatimore ndaj shtetit.
- i) Dokument nga Gjykata e rrethit përkatës që vërteton se nuk është në proces gjyqësor në lidhje me aktivitetin e tij.

Në rast se aplikanti nuk plotëson të gjitha kriteret e lartpërmendura nuk kualifikohet.

4. Aplikimi

Aplikimet paraqiten pranë AZHBR-së, Tiranë sipas formularit përkatës (nr.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi) dhe bashkëngjitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën II-A-3. Afati i fundit i paraqitjes së dokumenteve do të jetë data 15 maj 2009.

AZHBR-ja me mbarimin e afatit të aplikimit, brenda datës 30 maj 2009 bën vlerësimin e kërkesave të paraqitura dhe përzgjedhjen e subjekteve ose shoqërive fituese.

5. Vlerësimi i projekteve

Komisioni i Vlerësimit të Projekteve për mbështetje me kredi nga FKP-ja krijohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AZHBR-së dhe përbëhet nga 5 specialistë të fushave: ekonomike, juridike, bujqësore.

6. Kriteret e vlerësimit

Aplikanti duhet të plotësojë të gjitha kriteret që paraqiten në pikën II-A-3 të këtij udhëzimi. Vlerësimi do të bëhet nga një komisioni i AZHBR-së në bazë të pikëve të grumbulluara. Aplikanti duhet të marrë minimumin 70 pikë për t'u shpallur fitues, të cilët renditen sipas rendit prioritar mbi bazën e pikëve të fituara.

Pikët për këtë vlerësim janë si më poshtë:

- Biznesplani i detajuar	30 pikë
- Zona ku ushtron aktivitetin subjekti. Vlerësim maksimal kanë ato subjekte që zhvillojnë aktivitetin e tyre në zonat prioritare	30 pikë
- Subjektet që aktivitetin e kanë me cikël të mbyllur	20 pikë
- Shoqëritë e prodhimit dhe tregtimit në bujqësi	5 pikë
- Investimi është planifikuar me kapital të përbashkët	5 pikë
- Subjektet ose shoqëritë që kanë një historik të ndërtuar në këtë fushë	5 pikë
- Subjektet ose shoqëritë që kanë kontrata ligjore me prodhuesit	5 pikë.

Komisioni i Vlerësimit të Projekteve të financuara nga fondi kundërparti i AZHBR-së bën vlerësimet e projekteve të paraqitura dhe përcakton projektet fituese (formulari nr.4, bashkëngjitur këtij udhëzimi).

7. Financimi

Procedura e financimit ndahet në dy faza:

Parafinancimi:

a) Subjekti/shoqëria duhet të paraqese dokumentacionin si vijon:

1. Leje ndërtimi për objektin.

2. Vërtetim nga ZRPP-ja të pasurisë/pasurive që do të përdoren për kolateral (sipas kriterit 3-c).

3. Deklaratë noteriale për mbartjen e detyrimeve financiare që rrjedhin nga vlerësimi i kolateralit dhe bllokimit të tij në hipotekë.

b) AZHBR-ja ka për detyrë:

1. Vlerësimin e kolateralit nëpërmjet një eksperti të licencuar në fushën përkatëse në bashkëpunim me specialistë të AZHBR-së.

2. Përgatitjen e planit të likuiditetit 7-vjeçar të shumës së principalit të përfituar. Llogaritja e planit të likuiditetit fillon nga data e livrimit të plotë të fondit, me një periudhë *grace* 1 (një) vit.

3. Lidhjen e kontratës së kredisë midis palëve (sipas modelit në aneks/ bashkëngjitur këtij udhëzimi).

4. Përgatit dokumentacionin për bllokimin e pasurisë/pasurive të paluajtshme që do të shërbejnë si kolateral, mbi të cilin do të vendoset barrë sigurie.

Subjekti përfitues mbart të gjitha detyrimet që lindin nga vlerësimi i pasurisë/pasurive, si dhe nga akti i bllokimit në hipotekë.

Financimi

- AZHBR-ja kryen transferimin e shumës së aprovuar në numrin e llogarisë së përfituesit në 2-3 këste në përputhje me planin e investimeve (përshkruar në biznesplan).

Disbursimi fillestar do të jetë jo më shumë se 30% të shumës së aprovuar dhe këstet e tjera të disbursimit do të bëhen sipas situacionit të investimit, pasi të jetë kryer akti i verifikimit, brenda vitit ushtrimor (deri 20 dhjetor 2009).

B. BLERJE DHE INSTALIM LINJASH TË PËRPUNIMIT TË QUMËSHTIT

1. Kriteria të përfitimit

- Përfitojnë subjektet fizike dhe juridike që kryejnë aktivitetin në blegtori, si dhe shoqëritë e prodhimit dhe tregtimit në bujqësi që janë të regjistruara dhe funksionojnë në bazë të ligjit nr.8088, datë 21.3.1996 “ Për shoqëritë e bashkëpunimit reciprok”, i ndryshuar. Zonat gjeografike prioritare janë zonat rurale: si Gjirokastra, Peshkopia, Kukësi, Berati, Lezha, Mirdita, Tropoja, Përmeti, Korça, Erseka.

- Subjektet fizike/juridike, fermerët, shoqëritë që janë debitorë ndaj ish-projektit “2KR/AZHBR” përjashtohen nga aplikimi.

2. Aktiviteti që mbështetet nëpërmjet kësaj mase

- Blerje dhe instalim linjash për përpunimin e qumështit (baxho).

3. Kriteret që duhet të plotesojë aplikanti:

Subjekti ose shoqëria aplikuese duhet të paraqesë pranë Drejtorisë së AZHBR-së, Tiranë, një dosje, që duhet të përmbajë këtë dokumentacion:

a) Të paraqesë biznesplanin e detajuar (3-vjeçar), i cili duhet të përfshijë:

- Prezantimin e shoqërisë ose subjektit fizik apo juridik, aktivitetin (nëse ka), regjistrimin si biznes pranë tatimeve, historikun bankar dhe financiar (nëse ka).

- Pasqyrat financiare (planinvestimin, analizat e qarkullimit të parasë (*cash flow*), analizë kosto produkti, burimet e financimit).

- Studim tregu mbi fushën e investimit (për llojin e produktit, kapaciteti ruajtës etj.).

- Planin e marketingut.

- Analizë risku.

b) Plandisenjimi për investimin (planimetria dhe skicimi i investimit).

c) Pronësia e tokës bazuar në planin e disenjimit (që mund të përdoret për kolateral dhe pa barrë hipotekore) që vërteton origjinën e pasurisë dhe një certifikatë aktuale të hipotekës (jo më herët se 3 muaj nga data e aplikimit). Në rastet kur toka ku do të bëhet investimi është me qira duhet të paraqitet kontratë qiraje ligjore, e cila duhet të ketë minimalisht kohëzgjatje për 10 vjet.

d) Përfituesi duhet të ketë një kolateral të mjaftueshëm dhe jo më pak se 100% të vlerës së përfituar. Në kolateral përfshihen pasuri të paluajtshme (truall, tokë bujqësore, objekte etj.).

e) Marrëveshje paraprake për blerjen e pajisjeve, si dhe përshkrimet teknike të tyre. Teknologjia që do të përdoret, makineritë duhet të jenë të reja dhe të certifikuara nga KE.

f) Kontrata apo marrëveshje me furnizuesit apo blerësit për produktet.

g) Dokumente që vërtetojnë që përfituesi nuk ka mbi vete asnjë barrë detyrimi bankar nga Banka e Shqipërisë, regjistri i kredisë.

h) Dokument nga zyra e tatimeve që nuk ka detyrime tatimore ndaj shtetit.

Dokument nga Gjykata e rrethit përkatës që vërteton se nuk është në proces gjyqësor në lidhje me aktivitetin e tij.

Në rast se aplikanti nuk plotëson të gjitha kriteret e lartpërmendura nuk kualifikohet.

4. Aplikimi

Aplikimet paraqiten pranë AZHBR-së, Tiranë sipas formularit përkatës (nr.2, bashkëngjitur këtij udhëzimi) dhe bashkëngjitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën II-B-3. Afati i fundit i paraqitjes së dokumenteve do të jetë data 15 maj 2009.

AZHBR-ja me mbarrimin e afatit të aplikimit, brenda datës 30 maj 2009 bën vlerësimin e kërkesave të paraqitura dhe përzgjedhjen e subjekteve ose shoqërive fituese.

5. Vlerësimi i projekteve

Komisioni i Vlerësimit të Projekteve për mbështetje me kredi nga FKP-ja krijohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AZHBR-së dhe përbëhet nga 5 specialistë të fushave: ekonomike, juridike, bujqësore.

6. Kriteret e vlerësimit

Aplikanti duhet të plotësojë të gjitha kriteret që paraqiten në pikën II-B-3 të këtij udhëzimi. Vlerësimi do të bëhet nga një komisioni i AZHBR-së në bazë të pikëve të grumbulluara. Aplikanti duhet të marrë minimumin 70 pikë për t'u shpallur fitues, të cilët paguhet sipas rendit prioritar mbi bazën e pikëve të fituara.

Pikët për këtë vlerësim janë si më poshtë:

- Biznesplani i detajuar	30 pikë
- Zona ku ushtron aktivitetin subjekti. Vlerësim maksimal kanë ato subjekte që zhvillojnë aktivitetin në zonat prioritare	30 pikë
- Subjektet që aktivitetin e kanë me cikël të mbyllur, d.m.th. kanë një numër krerësh (jo më pak se 50 lopë ose 200 të imta, ose ato që kanë planifikuar të ndërtojnë edhe pikë grumbullimi edhe linjë përpunimi	10 pikë
- Investimi është planifikuar me kapital të përbashkët.	5 pikë
- Subjektet ose shoqëritë që kanë një historik të ndërtuar në këtë fushë	5 pikë
- Subjektet ose shoqëritë që kanë kontrata ligjore me prodhuesit ose grumbulluesit e qumështit	10 pikë.
- Plotësimi i standardeve të sigurisë ushqimore (GMP).....	5 pikë
- Masat për mbrojtjen e mjedisit	5 pikë.

Komisioni i Vlerësimit të Projekteve të financuara nga fondi kundërparti i AZHBR-së bën vlerësimet e projekteve të paraqitura dhe përcakton projektet fituese (Formulari nr. 5, bashkëngjitur këtij udhëzimi).

7. Financimi

Procedura e financimit ndahet në dy faza:

Parafinancimi

c) Subjekti/shoqëria duhet të paraqesë dokumentacionit si vijon:

1. Leje ndërtimi për objektin.
2. Vërtetim nga ZRPP-ja të pasurisë/pasurive që do të përdoren për kolateral (sipas kriterit 3-c).
3. Deklaratë noteriale për mbartjen e detyrimeve financiare që rrjedhin nga vlerësimi i kolateralit dhe bllokimit të tij në hipotekë.

d) AZHBR-ja ka për detyrë:

1. Vlerësimin e kolateralit nëpërmjet një eksperti të licencuar në fushën përkatëse në bashkëpunim me specialistë të AZHBR-së.
2. Përgatitjen e planit të likuiditetit 7-vjeçar të shumës së principalit të përfutur. Llogaritja e planit të likuiditetit fillon nga data e livrimit të plotë të fondit, me një periudhë *grace* 1 (një) vit.
3. Lidhjen e kontratës së kredisë midis palëve (sipas modelit në aneks/ bashkëngjitur këtij udhëzimi).
4. Përgatit dokumentacionin për bllokimin e pasurisë/pasurive të paluajtshme që do të shërbejnë si kolateral, mbi të cilin do të vendoset barrë sigurie.

Subjekti përfitues mbart të gjitha detyrimet që lindin nga vlerësimi i pasurisë/pasurive, si dhe nga akti i bllokimit në hipotekë.

Financimi

- AZHBR-ja kryen transferimin e shumës së aprovuar në numrin e llogarisë së përfituesit në 2-3 këste në përputhje me planin e investimeve (përshkruar në biznesplan).

Disbursimi fillestar do të jetë jo më shumë se 30% të shumës së aprovuar dhe këstet e tjera të disbursimit do të bëhen sipas situacionit të investimit, pasi të jetë kryer akti i verifikimit, brenda vitit ushtrimor (deri 20 dhjetor 2009).

C. BLERJE DHE INSTALIM LINJASH TË PËRPUNIMIT TË FRUTA-PERIMEVE

1. Kriteria të përfitimit

- Përfitojnë subjektet fizike dhe juridike që kryejnë aktivitetin në bujqësi, si dhe shoqëritë e prodhimit dhe tregtimit në bujqësi që janë të regjistruara dhe funksionojnë në bazë të ligjit nr.8088, datë 21.3.1996 “ Për shoqëritë e bashkëpunimit reciprok”, i ndryshuar.

Zonat gjeografike prioritare janë:

I. Për përpunim frutash

Korça, Pogradeci, Peshkopia, Berati, Vlora, Kukësi, Tropoja.

II. Për përpunim perimesh.

Tirana, Durrësi, Lushnja, Fieri, Berati, Lezha, Shkodra, Saranda.

- Subjektet fizike/juridike, fermerët, shoqëritë që janë debitorë ndaj ish-projektit “2KR/AZHBR” përjashtohen nga aplikimi.

2. Aktiviteti që mbështetet nëpërmjet kësaj mase

- Blerje dhe instalim linjash për përpunimin e fruta-perimeve, me përjashtim të linjave që përdoren për prodhimin e pijeve alkoolike (verës, rakisë etj.).

3. Kriteret që duhet të plotësojë aplikanti:

Subjekti ose shoqëria aplikuese duhet të paraqesë pranë Drejtorisë së AZHBR-së, Tiranë një dosje, që duhet të përmbajë këtë dokumentacion:

a) Të paraqesë biznesplanin e detajuar (3-vjeçar), i cili duhet të përfshijë:

- Prezantimin e shoqërisë ose subjektit fizik apo juridik, aktivitetin (nëse ka), regjistrimin si biznes pranë tatimeve, historikun bankar dhe financiar (nëse ka).

- Pasqyrat financiare (planinvestimit, analizat e qarkullimit të parasë (*cash flow*), analizë kosto produkti, burimet e financimit).

- Studim tregu mbi fushën e investimit (për llojin e produktit, kapaciteti ruajtës etj.).

- Planin e marketingut.

- Analizë risku.

b) Plan disenjimi për investimin (planimetria dhe skicimi i investimit).

c) Pronësia e tokës bazuar në planin e disenjimit (që mund të përdoret për kolateral dhe pa barrë hipotekore) që vërteton origjinën e pasurisë dhe një certifikatë aktuale (jo më herët se 3 muaj nga data e aplikimit) të hipotekës. Në rastet kur toka ku do të bëhet investimi është me qira duhet të paraqitet kontratë qiraje ligjore, e cila duhet të ketë minimalisht kohëzgjatje për 10 vjet.

d) Përfituesi duhet të ketë një kolateral të mjaftueshëm dhe jo më pak se 100% të vlerës së përfituar. Në kolateral përfshihen pasuri të paluajtshme (truall, tokë bujqësore, objekte etj.).

e) Marrëveshje paraprake për blerjen e pajisjeve, si dhe përshkrimet teknike të tyre. Teknologjia që do të përdoret, makineritë duhet të jenë të reja dhe të certifikuara nga KE.

f) Kontratë apo marrëveshje me furnizuesit apo blerësit për produktet.

g) Dokumente që vërtetojnë që përfituesi nuk ka mbi vete asnjë barrë detyrimi bankar nga Banka e Shqipërisë, regjistri i kredisë.

h) Dokument nga zyra e tatimeve që nuk ka detyrime tatimore ndaj shtetit.

i) Dokument nga gjykata e rrethit përkatës që vërteton se nuk është në proces gjyqësor në lidhje me aktivitetin e tij.

Në rast se aplikanti nuk plotëson të gjitha kriteret e lartpërmendura nuk kualifikohet.

4. Aplikimi

Aplikimet paraqiten pranë AZHBR-së, Tiranë sipas formularit përkatës (nr.3, bashkëngjitur këtij udhëzimi) dhe bashkëngjitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën II-C-3. Afati i fundit i paraqitjes së dokumenteve do të jetë data 15 maj 2009.

AZHBR-ja me mbarrimin e afatit të aplikimit, brenda datës 30 maj 2009 bën vlerësimin e kërkesave të paraqitura dhe përzgjedhjen e subjekteve ose shoqërive fituese.

5. Vlerësimi i projekteve

Komisioni i Vlerësimit të Projekteve për mbështetje me kredi nga FKP-ja krijohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AZHBR-së dhe përbëhet nga 5 specialistë të fushave: ekonomike, juridike, bujqësore.

6. Kriteret e vlerësimit

Aplikanti duhet të plotësojë të gjitha kriteret që paraqiten në pikën II-C-3 të këtij udhëzimi. Vlerësimi do të bëhet nga një komisioni i AZHBR-së në bazë të pikëve të grumbulluara. Aplikanti duhet të marrë minimumin 70 pikë për t'u shpallur fitues, të cilët paguhën sipas rendit prioritar mbi bazën e pikëve të fituara.

Pikët për këtë vlerësim janë si më poshtë:

- Biznesplani i detajuar 30 pikë
- Zona ku ushtron aktivitetin subjekti. Vlerësim maksimal kanë ato subjekte që zhvillojnë aktivitetin e tyre në zonat prioritare..... 30 pikë
- Subjektet që aktivitetin e kanë me cikël të mbyllur 5 pikë
- Shoqëritë e prodhimit dhe tregtimit në bujqësi..... 5 pikë
- Investimi është planifikuar me kapital të përbashkët..... 5 pikë
- Subjektet ose shoqëritë që kanë një historik të ndërtuar në këtë fushë 5 pikë
- Subjektet ose shoqëritë që kanë kontrata ligjore me prodhues/grumbullues..... 10 pikë
- Plotësimi i standardeve të sigurisë ushqimore (GMP), 5 pikë
- Masat për mbrojtjen e mjedisit 5 pikë.

Komisioni i Vlerësimit të Projekteve të financuara nga fondi kundërparti i AZHBR-së bën vlerësimet e projekteve të paraqitura dhe përcakton projektet fitues (Formulari nr.6, bashkëngjitur këtij udhëzimi)

7. Financimi

Procedura e financimit ndahet në dy faza:

Parafinancimi

e) Subjekti/shoqëria duhet të paraqesë dokumentacionin si vijon:

1. Leje ndërtimi për objektin.

2. Vërtetim nga ZRPP-ja, të pasurisë/pasurive që do të përdoren për kolateral (sipas kriterit 3-c).

3. Deklaratë noteriale për mbartjen e detyrimeve financiare që rrjedhin nga vlerësimi i kolateralit dhe bllokimit të tij në hipotekë.

f) AZHBR-ja ka për detyrë:

1. Vlerësimin e kolateralit nëpërmjet një eksperti të licencuar në fushën përkatëse në bashkëpunim me specialistë të AZHBR-së.

2. Përgatitjen e planit të likuiditetit 7-vjeçar të shumës së principalit të përfituar. Llogaritja e planit të likuiditetit fillon nga data e livrimit të plotë të fondit, me një periudhë *grace* 1 (një) vit.

3. Lidhjen e kontratës së kredisë midis palëve (sipas modelit në aneks/bashkëngjitur këtij udhëzimi).

4. Përgatit dokumentacionin për bllokimin e pasurisë/pasurive të paluajtshme që do të shërbejnë si kolateral, mbi të cilin do të vendoset barrë sigurie.

Subjekti përfitues mbart të gjitha detyrimet që lindin nga vlerësimi i pasurisë/pasurive, si dhe nga akti i bllokimit në hipotekë.

Financimi

- AZHBR-ja kryen transferimin e shumës së aprovuar në numrin e llogarisë së përfituesit në 2-3 këste në përputhje me planin e investimeve (përshkruar në biznesplan).

Disbursimi fillestar do të jetë jo më shumë se 30% të shumës të aprovuar dhe kështu e tjera të disbursimit do të bëhen sipas situacionit të investimit, pasi të jetë kryer akti i verifikimit, brenda vitit ushtritor (deri 20 dhjetor 2009).

III. ADMINISTRIMI I FONDIT KUNDËRPARTI

1. AZHBR-ja fton subjektet përfituese të kredisë me afat shlyerjeje 7-vjeçare dhe interes 0, për masat dhe fushën e financimit të lartpërmendura, të lidhin kontrata të noterizuara, para procesit të disbursimit, sipas dispozitave ligjore në fuqi. Tipi i kontratës është bashkëngjitur këtij udhëzimi.

2. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm i AZHBR-së, për lidhjen dhe nënshkrimin e kontratave me subjektet përfituese.

3. Brenda strukturës së miratuar të AZHBR-së, ngarkohen specialistë për monitorimin, menaxhimin e drejtimit financiar dhe teknik, si dhe kthimin e fondit kundërparti/buxhetor nga çdo subjekt përfitues. Specialistët e sektorit përkatës mbajnë dokumentacion të plotë dhe ndjekin vijueshmërinë e shlyerjes së kësteve përshkruar në kontratat përkatëse.

4. AZHBR-ja, në bashkëpunim me organet tatimore dhe të rendit, ka të drejtë të ushtrojë kontroll teknik dhe financiar mbi veprimtarinë ekonomike që subjekti kryen, gjendjen teknike etj., për sa kohë që nuk është paguar kësti i fundit.

5. Subjekti përfitues është i detyruar të raportojë dhe të japë informacion në AZHBR, për të dhënat që i kërkohen prej tij dhe mban përgjegjësi për saktësinë e tyre.

6. Shlyerja e detyrimit të principalit do të jetë me 2-3 këste në vit, me një periudhë *grace* 1 (një) vit, që fillon nga data e nënshkrimit të kontratës. Kthimi i kredisë do të arkëtohet në llogari rrjedhëse të veçantë të AZHBR-së .

7. Për rastet e mospagimit në kohë të këstit, subjekti përfitues penalizohet me një kamatë vonesë vjetore 5 % të vlerës të këstit të papaguar e llogaritur kjo për çdo ditë pune.

8. Kur subjekti përfitues, pagues i rregullt i kësteve nuk paguan 2 këste të radhës, të cilat janë pasqyruar në kontratë, organet tatimore në bashkëpunim me AZHBR kryejnë bllokimin e aktivitetit ekonomik të subjektit/shoqërisë, si dhe AZHBR-ja ndjek dispozitat ligjore në fuqi duke iu drejtuar organeve gjyqësore dhe atyre të përmbartimit për ekzekutimin e kolateralit të bllokuar.

9. AZHBR-ja ka të drejtë të bllokojë disbursimin e kredisë dhe të kërkojë ndjekjen ligjore pranë organeve kompetente (gjykatë, përmbartim), në rastet kur përfituesi devijon qëllimin e përdorimit të kredisë.

10. Për rastet e patrajuara nga ky udhëzim, në se gjykohet për efekte të faktorëve objektive me propozim të AZHBR-së Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit përcakton mënyrën e zgjidhjes me urdhër të veçantë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Jemin Gjana

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan BODE

NDËRTIM DHOMASH FRIGORIFERIKE

Formulari Aplikimit dhe Dorezimit Nr.1

1) Emri i aplikantit ose Shoqërise aplikuese		2) Data e aplikimit	
3) Subjekti:			
☐ Fizik ☐ Juridik ☐ Shoqëri të bashkëpunimit reciprok			
4) Emertimi i subjektit :			
5) Nipti :			
6) Adresa :			
7) Telefon :		8) E-mail :	
9) Fax :			
10) Fusha e investimit			
11) Qellimi i investimit			
Shuma e investimit		12) Shuma e kërkuar nga AZHBR	
leke		leke	
13) Lloji e produktit në ruajtje			
15) Kapaciteti i dhomes frigoriferike			
16) Dokumentacioni bashkëgënjitur			
➤ Biznes-plan		☐	Jo
➤ Plan- dizenjimi		☐	Jo
➤ Pronesia ligjore në zotërim		☐	Jo
➤ Pronesi/Kolateral		☐	Jo
➤ Marreveshja ose ofertat e pajisjeve		☐	Jo
➤ Kontrata apo marreveshje me furnizues/blerës		☐	Jo
➤ Vertetim bankar që nuk mbart detyrime bankare të tjera		☐	Jo
➤ Dokument nga zyra e tatimeve për mosdetyrime		☐	Jo
17) Nënshkrimi i aplikantit			
18) Marresit në dorezim			

NDËRTIM DHOMASH FRIGORIFERIKE

Formulari Vleresimit Nr.4

1) Emri i aplikantit ose Shoqerise aplikuese _____		2) Data e aplikimit _____	
		3) Data e Vleresimit _____	
4) Subjekti:			
☐ Fizik ☐ Juridik ☐ Shoqeri te bashkepunimit reciprok			
4) Emertimi i subjektit :			
5) Nipti :			
6) Adresa :			
7) Telefon :		8) E-mail :	
9) Fusha e investimit			
11) Shuma e investimit leke		12) Shuma e Aprovuar nga AZHBR leke	
13) Lloji e produktit ne ruajtje			
14) Kapaciteti i dhomes frigoriferike			
15) Akti Vleresimit			
➤ Biznes plani	Kriteri	pikeve	Vleresimi
➤ Zona ku ushtron aktivitet /prioritare		30	
➤ Aktivitet me cikël te mbyllur		30	
➤ Shoqeri Podhimi dhe Tregtimi Bujqesor		20	
➤ Kapital I perbashket investues		5	
➤ Eksperience (historik) te meparshem ne kete fushe		5	
➤ Kontrata me prodhues		5	
TOTALI		100	TOTALI
16) Nenshkrimi i Komisionit Vleresimit		1. _____	
2. _____		3. _____	
4. _____		5. _____	

BLERJE DHE INSTALIM LINJASH PËR PËRPUNIMIN E QUMËSHITIT

Formulari Aplikimit dhe Dorezimit Nr.2

1) Emri i aplikantit ose Shoqërise aplikuese _____	2) Data e aplikimit _____
3) Subjekti:	
☐ Fizik ☐ Juridik ☐ Shoqëri të bashkëpunimit reciprok	
4) Emertimi i subjektit :	
5) Nipti :	
6) Adresa :	
7) Telefon :	8) E-mail :
9) Fax :	
10) Fusha e investimit	
11) Qëllimi i investimit	
12) Shuma e investimit leke	13) Shuma e kërkuar nga AZHBR leke
14) Kapaciteti i linjes perpunuese	
15) Lloji i produktit	
16) Dokumentacioni bashkëgjitur	
➤ Biznes-plani	Po ☐ Jo ☐
➤ Plan dizenjimi	Po ☐ Jo ☐
➤ Pronesia ligjore në zotërim	Po ☐ Jo ☐
➤ Pronesi/Kolateral	Po ☐ Jo ☐
➤ Marreveshja ose ofertat e pajisjeve	Po ☐ Jo ☐
➤ Kontrata me furnizuesit/bleresit	Po ☐ Jo ☐
➤ Vertetim bankar që nuk mbart detyrime bankare të tjera	Po ☐ Jo ☐
➤ Dokument nga zyra e tatimeve për mosdetyrime tatimore	Po ☐ Jo ☐
17) Nenshkrimi i aplikantit	
18) Marresit në dorezim	

BLERJE DHE INSTALIM LINJASH PËR PËRPUNIMIN E FRUTA-PERIMEVE

Formulari Aplikimit dhe Dorëzimit Nr.3

1) Emri i aplikantit ose Shoqërise aplikuese _____	2) Data e aplikimit _____
3) Subjekti:	
☐ Fizik ☐ Juridik ☐ Shoqëri të bashkëpunimit reciprok	
4) Emërtimi i subjektit :	
5) Nipti :	
6) Adresa :	
7) Telefon :	8) E-mail :
9) Fax :	
10) Fusha e investimit	
11) Qëllimi i investimit	
12) Shuma e investimit leke	13) Shuma e kërkuar nga AZHBR leke
14) Lloji i produktit të përpunuar	
15) Dokumentacioni bashkëgjitur	
➤ Biznes-plan	Po ☐ Jo ☐
➤ Plan-dizënjim	Po ☐ Jo ☐
➤ Pronesia ligjore në zotërim	Po ☐ Jo ☐
➤ Pronesi/Kolateral	Po ☐ Jo ☐
➤ Marreveshja ose oferta të pajisjeve	Po ☐ Jo ☐
➤ Kontrata me furnizuesit/ blerësit të lëndës së parë	Po ☐ Jo ☐
➤ Vertetim që nuk mbart detyrime bankare të tjera	Po ☐ Jo ☐
➤ Dokument nga zyra e tatimeve për mosdetyrime	Po ☐ Jo ☐
17) Nënshkrimi i aplikantit	
18) Marrësit në dorëzim	

BLERJE DHE INSTALIM LINJASH PËR PËRPUNIMIN E QUMËSHTIT

Formulari Vleresimit Nr.5

1) Emri i aplikantit ose Shoqerise aplikuese _____		2) Data e Aplikimit _____	
		3) Data e Vleresimit _____	
4) Subjekti:			
☐ Fizik ☐ Juridik ☐ Shoqeri te bashkepunimit reciprok			
5) Emertimi i subjektit :			
6) Nipti :			
7) Adresa :			
8) Telefon :		9) E-mail :	
10) Fusha e investimit			
11) Shuma e investimit leke		12) Shuma e Aprovuar nga AZHBR leke	
14) Kapaciteti i linjes perpunuese			
15) Lloji i produktit			
16) Akti Vleresimit			
➤ Biznes-plani		Kriteri pikeve	Vleresimi
		30	
➤ Zona ku ushtrohet aktiviteti/prioritare		30	
➤ Aktivitet me cikel te mbyllur		10	
➤ Kapital i perbashket investues		5	
➤ Eksperience (historik) te meparshme ne kete fushe		5	
➤ Kontrata me prodhues/grumbullues		10	
➤ Plotesimi i standarteve, kushtet e punes		5	
➤ Mbrotjtja e mjedisit		5	
TOTALI		100	TOTALI
18) Nenshkrimi i Komisionit Vleresimit		1. _____	
2. _____		3. _____	
4. _____		5. _____	

BLERJE DHE INSTALIM LINJASH TË PËRPUNIMIN E FRUTA-PERIMEVE

Formulari Vleresimit Nr.6

1) Emri i aplikantit ose Shoqerise aplikuese _____		2) Data e Aplikimit _____ 3) Data Vleresimit _____																																	
4) Subjekti: ☐ Fizik ☐ Juridik ☐ Shoqeri te bashkepunimit reciprok																																			
5) Emertimi i subjektit :																																			
6) Nipti :																																			
7) Adresa :																																			
8) Telefon :	9) E-mail :																																		
10) Fusha e investimit																																			
11) Shuma e investimit leke	12) Shuma e Aprovuar nga AZHBR leke																																		
13) Lloji i produktit te perpunuar																																			
<table style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <th style="width: 50%; text-align: left;">14) Akti Vleresimit</th> <th style="width: 15%; text-align: center;">Kriteri pikeve</th> <th style="width: 35%; text-align: center;">Vleresimi</th> </tr> <tr> <td>➤ Biznes-plani</td> <td style="text-align: center;">30</td> <td></td> </tr> <tr> <td>➤ Zona ku ushtrohet aktiviteti/prioritare</td> <td style="text-align: center;">30</td> <td></td> </tr> <tr> <td>➤ Aktivitet me cikël të mbyllur</td> <td style="text-align: center;">5</td> <td></td> </tr> <tr> <td>➤ Shoqerite e Prodhimit dhe Tregtimit</td> <td style="text-align: center;">5</td> <td></td> </tr> <tr> <td>➤ Kapital i perbashket investues</td> <td style="text-align: center;">5</td> <td></td> </tr> <tr> <td>➤ Eksperience (historik) te meparshme ne kete fushe</td> <td style="text-align: center;">5</td> <td></td> </tr> <tr> <td>➤ Kontrata me prodhues/grumbullues</td> <td style="text-align: center;">10</td> <td></td> </tr> <tr> <td>➤ Plotesimi standarteve, kushtet e punes,etj</td> <td style="text-align: center;">5</td> <td></td> </tr> <tr> <td>➤ Mbrojtja e mjedisit</td> <td style="text-align: center;">5</td> <td></td> </tr> <tr> <td style="text-align: right;">TOTALI</td> <td style="text-align: center;">100</td> <td style="text-align: center;">TOTALI</td> </tr> </table>			14) Akti Vleresimit	Kriteri pikeve	Vleresimi	➤ Biznes-plani	30		➤ Zona ku ushtrohet aktiviteti/prioritare	30		➤ Aktivitet me cikël të mbyllur	5		➤ Shoqerite e Prodhimit dhe Tregtimit	5		➤ Kapital i perbashket investues	5		➤ Eksperience (historik) te meparshme ne kete fushe	5		➤ Kontrata me prodhues/grumbullues	10		➤ Plotesimi standarteve, kushtet e punes,etj	5		➤ Mbrojtja e mjedisit	5		TOTALI	100	TOTALI
14) Akti Vleresimit	Kriteri pikeve	Vleresimi																																	
➤ Biznes-plani	30																																		
➤ Zona ku ushtrohet aktiviteti/prioritare	30																																		
➤ Aktivitet me cikël të mbyllur	5																																		
➤ Shoqerite e Prodhimit dhe Tregtimit	5																																		
➤ Kapital i perbashket investues	5																																		
➤ Eksperience (historik) te meparshme ne kete fushe	5																																		
➤ Kontrata me prodhues/grumbullues	10																																		
➤ Plotesimi standarteve, kushtet e punes,etj	5																																		
➤ Mbrojtja e mjedisit	5																																		
TOTALI	100	TOTALI																																	
15) Nenshkrimi i Komisionit Vleresimit																																			
1. _____ 2. _____ 4. _____	1. _____ 3. _____ 5. _____																																		

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
NR. _____ REP.
NR. _____ KOL.

KONTRATE KREDIE

Nr. / Datë / /2009

Në Tiranë, sot më _____ 2009 (dy mijë e nëntë), në zyrën e noterisë Tiranë, para meje noteres _____, u paraqitën palët:

a) Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, me seli pranë MBUMK- së, e krijuar në bazë të ligjit nr.----- dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1443, datë 30.10.2008, (dhe në vazhdim do të quhet “HUADHËNËSI”) , e përfaqësuar nga Z. _____, me cilësinë _____, me dokument identiteti _____

dhe

b) Subjekti fizik/juridik, shoqëria me emër “_____” me adresë: rruga “_____”, nr. _____, Shqipëri, e krijuar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor / Tiranë nr. _____ datë __.__.____, e regjistruar në organet tatimore _____ me kodin fiskal Nr. _____ dhe NIPT nr. _____ (dhe në vazhdim do të quhet “HUAMARRËSI”) nga ana tjetër; e përfaqësuar këtu e më poshtë nga ortakut dhe administratori i vetëm/aksioneri i vetëm / Drejtori i Përgjithshëm Z./ Znj. _____, i biri i / e bija e _____, lindur në _____, me __.__.____, banues/e në _____, në adresën rruga “_____”, pall. _____, shk. _____, kati _____, ap. _____ mbajtës/e i/e pasaportës/letërnjoftimit/certifikatës nr. _____, madhor/e, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

BAZA LIGJORE: Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1443, datë 30.10.2008, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 12.3.2009.

HYRJE

SHPJEGIMI I TERMAVE:

Për efekt të kësaj kontrate termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

Kredi - për efekt të kësaj kontrate, termi kredi nënkupton huanë e marrë nga Huamarrësi;

Këst - është shuma që paguhet sipas grafikut të pagesave dhe përbëhet nga principali;

Kamatëvonesë - është përqindja e aplikuar mbi këstin e papaguar sipas kontratës.

Neni 1

Ojekti i kontratës

1.1 Huadhënësi i jep Huamarrësit një hua pa interes, me afat 7-vjeçar duke filluar nga data e livrimit të plotë të fondit, me kushtet e përcaktuara në këtë kontratë.

1.2 Huaja do të përdoret nga Huamarrësi, sipas qëllimit të përcaktuar

Neni 2

Mënyra e livrimit të huasë

2.1 Palët bien dakord që huaja të transferohet në llogarinë e Huamarrësit me anë të një transferte bankare.

2.2 AZHBR-ja kryen transferimin e shumës së aprovuar në numrin e llogarisë së përfituesit në 2-3 këste në përputhje me planin e investimeve (përshkruar në biznesplan).

2.3 Disbursimi fillestar do të jetë jo më shumë se 30% të shumës së aprovuar dhe kështu e tjera të disbursimit do të bëhen sipas situacionit të investimit, pasi të jenë kryer aktet përkatëse të verifikimit, brenda vitit ushtrimor (deri 20 dhjetor 2009).

Neni 3 Pagimi i huasë

3.1 Shlyerja e detyrimit të principalit do të jetë me 2-3 këste në vit, me një periudhë *grace* 1 (një) vit, duke filluar nga data e livrimit të plotë të fondit.

3.2 Këstet e huasë do të paguhën sipas grafikut në përputhje me aneksin e kësaj kontrate (grafiku i pagesave).

3.3 Pagesa e çdo kësti do të kryhet në një llogari rrjedhëse të veçantë të AZHBR-së, siç është përcaktuar në aneksin e kësaj kontrate.

3.4 Kur dita e përcaktuar për pagimin e kështit bie në ditët e pushimit ose festave zyrtare, data e pagimit do të jetë dita pasardhëse.

3.5 Huamarrësi mund ta shlyej huanë përpara afatit të përcaktuar në aneksin e kësaj kontrate.

Neni 4 Veprimet që ndërmerren në rastet e mospagimit të huasë në afat apo nga përdorimi për një qëllim të ndryshëm

4.1 Në rast se Huamarrësi nuk bën pagesën e kështit në datën e përcaktuar sipas aneksit të kësaj kontrate, atëherë ai detyrohet të paguajë një kamatëvonesë vjetore 5% të vlerës së kështit të pa paguar.

4.2 Huamarrësi nuk ka të drejtë të kërkojë hua tjetër deri sa ai nuk ka shlyer më parë shumën e plotë të kësaj huaje, si dhe në rastet kur nuk ka paguar në kohë këstet e huasë në përputhje me aneksin e kësaj kontrate.

4.3 Huadhënësi mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të pjesës së mbetur të huasë nëse konstaton se Huamarrësi nuk e përdor huanë sipas nenit 1 të kësaj kontrate, si dhe kur nuk ka marrë me shkrim miratimin me shkrim të Huadhënësit.

Neni 5 Të drejta dhe detyrime të tjera të Huamarrësit

5.1 Huamarrësi ka detyrime ta informojë huadhënësin me informacionin financiar të nevojshëm, duke i vënë në dispozicion pasqyra të sakta ku të paraqiten të ardhurat dhe detyrimet financiare të tij.

5.2 Huamarrësi ka detyrimin ta lejojë Huadhënësin të kryejë verifikimin e ecurisë të kësaj aktiviteti pa e penguar.

5.3 Huamarrësi është i detyruar ta njoftojë Huadhënësin në rast se ndryshon selinë e ushtrimit të aktivitetit të tij.

Neni 6 Taksa e shpenzimeve

6.1 Çdo shpenzim, tarifë aplikimi, shpenzime noteriale, taksa e tatime që rrjedhin nga nënshkrimi i kësaj kontrate do të paguhën nga Huamarrësi si: shpenzimet në lidhje me regjistrimin, e vendosjen e hipotekës mbi pasuritë e paluajtshme, si dhe shpenzimet që kanë të bëjnë me sigurimin e pasurisë.

6.2 Shpenzimet që lidhen me proceset gjyqësore, vendimet e ekzekutimit nga përmbarimi do t'u mbahen Huamarrësit nga kolaterali.

Neni 7 **Hipotekë**

7.1 Për të siguruar pagimin e huasë dhe të gjitha detyrimet e tjera në këtë kontratë Huamarrësi vendos si garanci pasurore (kolateral) pasurinë e tij të paluajtshme në masën 100% të vlerës së huasë së marrë.

7.2 Pasuria /kolaterali qëndron i bllokuar deri në shlyerjen e plotë të huasë.

7.3 Hipoteka funksionon e shuhet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil.

7.4 Në rast se Huamarrësi kërkon të ndryshojë pasurinë e vendosur si garanci për shlyerjen e detyrimit, ai duhet të marrë më parë miratimin me shkrim të Huadhënësit.

7.5 Huamarrësi merr përsipër, që në rast të mosshlyerjes së huasë së marrë për shkak se kolaterali i tij ka një vlerë më të vogël se huaja e marrë, të kompesojë pjesën e huasë së papaguar me çdo pasuri tjetër që ai disponon dhe e ka në pronësi të tij, qoftë kjo dhe pasuri e luajtshme dhe/ose e paluajtshme .

7.6 Garancia pasurore e vënë në favor të huadhënësit shtrihet mbi të gjitha përmirësimet, ndërtimet e shtojcat e tjera aktuale dhe të ardhshme të kryera mbi të, të drejtat, si dhe çdo regjim tjetër të veçantë të njohur me ligj mbi një pjesë ose në gjithë këtë pasuri.

7.7 Hipoteka fshihet kur:

- Të gjitha detyrimet financiare janë shlyer tërësisht (principali, kamatëvonesat etj).
- Huadhënësi mund të heqë dorë, me shkrim, nga të drejtat mbi pronën e hipotekuar.

Neni 8 **Garancia pasurore**

8.1 Për të siguruar shlyerjen e huasë dhe të gjitha detyrimeve të tjera të përcaktuara në këtë kontratë, Huamarrësi vendos si garanci pasurore (kolateral) pasurinë e tij të paluajtshme.

8.2 Barrëdhënësi deklaron se:

- Do të paguajë shpenzimet e mirëmbajtjes dhe të sigurimit të sendeve/objekteve të lëna peng në emër të Huadhënësit, përkundrajt humbjes ose dëmtimit.
- Sendet/objektet e lëna si garanci pasurore do të përdoren për qëllime të ligjshme dhe sipas destinacionit të tyre.

Neni 9 **Zgjidhja e kontratës**

9.1 Zgjidhja e kontratës mund të bëhet:

- Me kërkesë të Huamarrësit, në rastin kur do të paguajë të gjithë shumën e huasë para afatit të parashikuar në këtë kontratë.

- Me kërkesë të Huadhënësit:

a) në rastin kur Huamarrësi ka ndryshuar qëllimin e përdorimit të huasë, në këtë rast Huadhënësi ka të drejtë të kërkojë kthimin e shumës së disbursuar në favor të Huamarrësit; dhe

b) në rastin kur Huamarrësi nuk ka përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, në këtë rast kontrata zgjidhet dhe Huamarrësi është i detyruar të paguajë shumën e kësteve të papaguara, shumën e mbetur dhe kamatëvonesat.

Në të dy rastet e mësipërme, Huadhënësi në bashkëpunim me organet kompetente merr masa për bllokimin e aktivitetit ekonomik të Huamarrësit për të cilin ai ka marrë huanë.

Neni 10
Të ndryshme

10.1 Kjo kontratë i nënshtrohet dhe drejtohet nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë. Çdo mosmarrëveshje që lidhet me ekzekutimin dhe interpretimin e kësaj kontrate do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

10.2 Çdo modifikim i kësaj kontrate do të bëhet vetëm me shkrim dhe vetëm mbas marrëveshjes midis palëve.

10.3 Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim midis palëve do të bëhet me shkrim dhe do të dërgohet me postë të regjistruar në adresat e tyre të përcaktuara në këtë kontratë ose në adresat e njoftuara më pas nga secila prej palëve dhe do të konsiderohet e marrë (dorëzuar) në momentin e nënshkrimit të dokumentit përkatës të marrjes në dorëzim nga pala pritese dhe në rast se ky nuk gjendet, njoftimi i dorëzohet njërit prej anëtarëve të familjes, fqinjëve ose portierit të ndërtesës.

Për të vërtetuar sa u thanë më sipër u hartua kjo kontratë në 3 (tri) kopje, nga të cilat palët morën nga një kopje. (Origjinali i tretë do t'i jepet noterit.)

Kjo kontratë huaje bëhet në bazë të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, si dhe konform vullnetit të lirë të palëve, pasi u kuptua nga palët, u nënshkrua rregullisht prej tyre para meje noterit.

PALËT		
HUADHËNËSI		HUAMARRËSI

UDHËZIM
Nr.348, datë 27.5.2009

**PËR PROCEDURAT DHE DETYRAT QË DUHET TË ZBATOJNË PREFEKTËT DHE
KRYETARËT E KOMUNAVE PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË UDHËTIMIT PËR
ZGJEDHËSIT PA PASAPORTË, TË CILËVE U DUHET TË UDHËTOJNË NGA ZONAT E
LARGËTA PËR TË APLIKUAR PËR LETËRNJOFTIM**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, ligjit nr.9972, datë 28.7.2008 “Për ratifikimin e “Kontratës koncesionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike” ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit të SAGEM Securite dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të ndërmarrjeve”, ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë“, ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.417, datë 22.4.2009 “Për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për zgjedhësit pa pasaportë, të cilëve u duhet të udhëtojnë nga zonat e largëta për të aplikuar për letërnjoftim”,

UDHËZOHJ:

1. Kryetarët e komunave të përfshira në listën bashkëlidhur vendimit të Këshillit të Ministrave nr.417, datë 22.4.2009 “Për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për zgjedhësit pa pasaportë, të cilëve u duhet të udhëtojnë nga zonat e largëta për të aplikuar për letërnjoftim” të evidentojnë listën me emrat e shtetasve pa pasaportë dhe që banojnë në fshatra me mbi 5 km larg qendrës së aplikimit për çdo fshat.

2. Në fund të çdo muaji kryetarët e komunave të dërgojnë në prefekturë listën e personave të trajtuar dhe shumën përkatëse.

3. Pas dorëzimit të listave dhe shumave përkatëse nga kryetarët e komunave, prefektët bëjnë vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur dhe në bazë të këtij dokumentacioni (tarifa e paguar dhe lloji i mjetit të transportit, sipas zonës përkatëse), paraqesin kërkesën pranë Ministrisë së Brendshme për shtesë fondi, të shoqëruar me relacion të hollësishëm.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Politikave Financiare, pas verifikimit të dokumentacionit, përgatisin kërkesën për rialokim fondesh në Ministrinë e Financës.

5. Pas çeljes së fondit nga Ministria e Financës dhe njoftimit nga Ministria e Brendshme, prefektët autorizojnë drejtuesit e njësive vendore për përdorimin e fondit të miratuar.

6. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen prefektët, kryetarët e njësive të përfshira në listën bashkëlidhur vendimit të Këshillit të Ministrave nr.417, datë 22.4.2009 “Për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për zgjedhësit pa pasaportë, të cilëve u duhet të udhëtojnë nga zona të largëta për të aplikuar për letërnjoftim, “Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Politikave Financiare.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

URDHËR
Nr.374, datë 6.6.2009

PËR ORARIN E PUNËS PËR ZYRAT E GJENDJES CIVILE NË BASHKI/NJËSI
BASHKIAKE/KOMUNA

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9972, datë 28.7.2008 “Për ratifikimin e kontratës koncesionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike“ ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupit të Sagem Securite dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”,

URDHËROJ:

1. Orari i punës për zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/ komuna nga datat 7. 6. 2009 deri më datë 28.6.2009, do të jetë nga ora 08.⁰⁰ deri 22.⁰⁰, për shtatë ditët e javës.

2. Moszbatimi i këtij orari konsiderohet kundërvajtje administrative dhe do të ndëshkohet sipas dispozitave ligjore.

3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, prefektët dhe kryetarët e bashkive/njësive bashkiake/komunave.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë

Hyri në shtyp më 11.6.2009
Doli nga shtypi më 11.6.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 28 lekë